

Hulumtim mbi doktorët që veprojnë jashtë spitaleve (1)

Infermierja Vjollca

Mulladahuti, pohon se ka trajtuar vetë një paciente, të cilës i bënin injeksion pa ilaç, vetëm me Aqua redestilata dhe asaj i kalonin dhimbjet me të vërtetë. Dr. Shkëlqim Sela - psikiatër, shpjegon se fiksimit e pacientëve, bindjet dhe sugjestionet ndihmojnë deri në një masë

Koha Laura PAPANIKU

Sistemi shëndetësor në Maqedoni i përjashton tërësisht nga legjislativi, mirëpo janë me qindra mjekët popullorë të cilët ia kanë dalë të shërojnë edhe pacientë të cilët nuk kanë mundur të gjejnë shërim në spital apo të cilët, para-prakisht mund të kishin marrë një diagnozë të rëndë mjekësore. Veprojnë tamam si alternativë e shërbimeve mjekësore, pasi këto të ashtuquajtur mjekë popullor, ia dalin të shërojnë dhe të ofrojnë ilaçe për sëmundje nga më të ndryshmet, duke nisur nga reuma dhe sëmundje shi-atike, thyerja e kockave deri te sëmundjet malinje. Në raste të shumta, rezultatet e shërimit në mënyrë popullore janë të dukshme, të prekshme dhe të provuara prej shumë kujt. Mirëpo, keqpërdorimi i afinitetit të tyre nga të tjerë mashtrues që fshihen pas epitetit të mjekut popullor, ka bërë që shumë herë të mos gjendet kufiri që ndan mashtruesit nga mjekët e vërtetë popullor. Si të parët ashtu edhe të dytët kanë pacientet e tyre, të cilët u besojnë me fanatizëm "doktorëve" të tyre ose për shkak të besëtytnive, sugjestionit ose sepse kanë rastisur të shërohen nga persona të cilët e kryejnë në mënyrë mjeshtërore një shërbim të caktuar mjekësor. Në qytetin e Dibrës, për shembull, doktorë popullor rregullojnë me aq mjeshtëri kockat e thyera apo të plasura, muskujt e ndrydhur, kërthizën e spërdredhur sa zor se do të kishte ndonjë mjek ortoped apo internist që mund t'jua kalonte në këtë zanat.

Pushonin dhimbjen me ujë të distiluar

Mjekët, refuzojnë se ndonjë pjesë e mjekësisë mund të përvetësohet si zanat prej dikujt që nuk është shkolluar dhe specializuar për mjekësi. Ajo, që sipas tyre i shtyn pacientët të ndjehen të "shëruar" është fiksimi apo bindja që ata mund të krijojnë ndaj një ilaci apo mjeku të caktuar. Infermierja Vjollca Muhalldauti, tregon se ka trajtuar vetë një paciente të këtille, para disa viteve. "Si tani më kujtohet një paciente e cila vuante nga ishiasi dhe i ishte fiksuar që për të ndalur dhimbjet duhet të merr injeksione për qetësim çdo gjashtë orë. E, meqë është e pa pranueshme ti japësh aq shumë ilaçe, pa nevojë,

Shërohen me ujë të distiluar, ngjisin kockat pa operacion



REMZI SUDOLLI
Kam shëruar njerëz, të cilët kanë shkuar jo vetëm në Spitalin e Dibrës, por edhe te specialistë dhe doktorë profesorë në Shkup apo në ndonjë klinikë tjetër. Unë kam rregulluar edhe ato persona, të cilëve mjeku u ka thënë se mënyra e vetme e shërimit është operimi

doktori na kishte njoftuar me fiksimin e pacientes dhe na kishte urdhëruar që ti bënim injeksion vetëm me ujë të distiluar (Aqua redestilata). Posa i bënim

injeksionin, pacientja binte rehat, qetësohej. Ja tani dhimbjet më pushuan komentonte pacientja". Infermierja Mulladahuti, tregon se "Aqua redestinata" përdoret si tretës për injeksionet tjera të cilat janë pluhur dhe logjikisht nuk mund të pushojnë dhimbjet. Mirëpo, te kjo pacientë ndikonte. Asaj vërtetë i pushonin dhimbjet", sqaron infermierja.

Ndikimin e bindjeve në shërimin ose përkëqesimin e sëmundjeve e pranon edhe shkenca e mjekësisë. Dr. Shkëlqim Sela - psikiatër, thotë se sugjestionet e njerëzve ndikojnë në shërimin e pacientëve. "Nuk mund të saktësohet tamam se deri në çfarë përqindje, mirëpo ndikojnë, pasi njeriu mund të fiksohet në një lloj ilaci dhe të mendon se vërtetë ai është ilaci që mundet ta shërojë dhe ai shërohet", thotë Sela, duke nënvizuar se në të gjitha rastet e këtilla pacientët duhet të jenë të sëmurë psikikisht. Persona të cilët kanë ide paranoike, halucinacione mund të fiksohen pas një ilaci dhe kur ta konsumojnë atë, mund ndjehen si të shëruar. Sela qartëson se

kjo kategori e pacientëve nuk është e thënë domosdoshmërisht të jenë edhe viktimë e atyre "doktorëve" të cilët shërojnë me duhaja, hajmali, kryqe apo ikona.

Zanat ose jo

Sëmundjet shpirtërore, të cilat janë të lidhura me psikikën, sipas tij është shumë vështirë të shërohen me metoda të atilla të cilat i përdorin "mjekët" e lartpërmendur. Ata mund të kenë efekt dhe mund të shërojnë eventualisht ndonjë neurozë të personave të fiksuar pas bindjeve paranoike fetare apo "recetave" për të mbushur ujë në shtatë çezma të cilat i japin disa të ashtuquajtur mjekë alternativ apo popullor, shpjegon ai. "Te njerëzit me neuroza edhe mund të vërehet efekti i atij lloj mjekimi, mirëpo vetëm nëse nuk ka ndonjë sëmundje psikike të diagnostifikuar apo ndonjë organ të sëmurë, por thjeshtë ka vetëm ndonjë neurozë", pohon doktori psikiatër.

"Mjekësia në asnjë mënyrë nuk mund të jetë zanat". Këtë përgjigje e merr nga çdo mjek që

punon në institucionet shëndetësore, mirëpo në praktikë - ka shumë raste që dëshmojnë të kundërtën. Pacientë të shëruar prej mjekëve popullor dëshmojnë se shërimin e "vërtetë" e kanë gjetur të mjekët popullor. "Ka 5 vjet, që kam gjetur doktorin tim. Prej kur mjeshtri Remzi Sudolli, më rregulloi pa asnjë intervenim mjekësor gjurin e këmbës së djathtë, të cilën e nxora prej vendit, nuk shkoj më në spital", tregon Miftar. P. Ky 33 vjeçar, i cili është arsimtar me profesion i beson plotësisht mjekut të tij. "Nuk do të kishte pranuar të hyn në dorën e mjekëve ortoped të spitalit, as për 100 vjet", thotë ai. Sudolli, ndërkaq, ka 30 vite që rregullon kocka, të nxjerra vendit apo të plasura, muskujt të ndrydhur apo mesin e bllokuar. Nëpër duart e tij kalojnë çdo ditë pacientë si puna e arsimtarit. "Kam shëruar raste shumë më të rënda se kocka të nxjerra. Nuk mundem të rregulloj vetëm ligamentin e këputur. Këtu nevojitet patjetër intervenim kirurgjikal, në spital nga mjeku specialist". Doktorë të këtille popullor, si

Sudolli, pretendojnë se mjekësia është zanat, mirëpo shkenca e mjekësisë nuk e pranon këtë. As në Qendrën Spitalore të Dibrës, nuk e pranojnë se "shërimi i vërtetë" mund të bëhet jashtë spitaleve dhe nga persona që nuk kanë kryer shkollimin përkatës.

Praktika me Sudollin, tregon të kundërtën. Ai, pohon se ka shëruar rastet për të cilat spitalet nuk kanë pasur sukses. "Kam shëruar njerëz, të cilët kanë shkuar jo vetëm në Spitalin e Dibrës, por edhe te specialistë dhe doktorë profesorë në Shkup apo në ndonjë klinikë tjetër. Unë kam rregulluar edhe ato persona, të cilëve mjeku u ka thënë se mënyra e vetme e shërimit është operimi", pohon ai. Për një rast të ndërlikuar, ishte thirrur të shkojë në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë.

Ortopedët e Spitalit pa pacientë

Një fëmijë, që kishte nxjerrë kockën e sipërme të këmbës (afër legenit) mjekët i kishin treguar se mënyra e vetme e rregullimit është operacioni. "Pasi pashë fotografinë e rëntgenit, i nxora të gjithë nga dhoma, në përjashtim të prindit i cili më ndihmoi duke e mbajtur djalin në pozitën e duhur. Pas pesë minutave, nisi të ecën si të mos ketë asgjë", shpjegon rastin Sudolli. Zanatin thotë se e kam marr nga nëna e tij, tani e ndjerë, Sibja, e cila gjithashtu ishte e shquar në këtë zanat, bile pak më tepër sepse i rregullonte edhe kockat e thyera. "Që si fëmijë e shihja nënën se si i shëron pacientët. I ndihmoja dhe më tregonte se si rregullon dhe kështu fillova të mësoj edhe unë", tregon ai, ndërkaq shpjegon se specialisti më i perfeksionuar prej tij janë këmbët e gjendje normale i kockave që "kanë marrë mish", respektivisht ka dalë mbi pjesën e muskulit. Punon kryesisht me fotografi të rëntgenit. "Këtë e dinë të gjithë pacientët, prandaj para se të vij në tek unë, shkojnë bëjnë rëntgenin dhe me fotografinë vijnë këtu. Ato që vijnë pa rëntgen, i dërgoj të bëjnë fotografinë në spital dhe të vijnë më vonë", tregon Sudolli, i cili leximin e rëntgenit e ka mësuar në mënyrë autodidakte. Si puna e tij, në këtë qytet e Dibrës ka edhe mjeshtër të tjerë, mesin e të cilëve edhe Irfan Kaja dhe Haxhi Ballanca. Këta të tre, i kanë nxjerrë thuasë në pension mjekët ortoped të spitalit. Fama e tyre ka depërtuar jo vetëm në të gjitha qytetet e Maqedonisë, prej nga u vijnë pacientë por edhe në shtete fshije të Shqipërisë dhe Kosovës. Te ortopedët e Qendrës Spitalore në Dibër, vitin e kaluar janë shënuar rreth 50 trajtime mjekësore. Kaq pacientë, ndonjëherë edhe më shumë kanë secili prej tri mjeshtërve të lartpërmendur vetëm për një muaj.

(vijon)

Ky hulumtim është bërë në bashkëpunim me organizatën daneze të gazetarisë hulumtuese SCOOP

